

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6391
E enjte, 19 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Haradinaj viziton në Burojë prindërit e Thaçit, u jep medalje

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTOHEN KRITIKAT NDAJ QEVERISË PËR MENAXHIM TË KEQ TË PANDEMISË

FAQE 4-5

KËRKOHEM DORËHEQJA E ARBEN VITISË



Rritja enorme e rasteve me Covid-19 në vend dhe zyrtarizimi i kandidaturës së Arben Vitisë për kryetar të komunës së Prishtinës ka shtuar zërat që ky i fundit të dorëhiqet nga posti i ministrit të

Shëndetësisë. Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK) dhe përfaqësuesit e opozitës kanë kërkuar nga Vitia ta lirojë detyrën e ministrit. Sipas tyre, Ministrinë e Shëndetësisë duhet

ta marrë në menaxhim dikush i cili është i përkushtuar për menaxhimin e pandemisë dhe për zgjidhjen e problemeve të shumta që kanë pacientët e Kosovës

AKTUALE




KATËR TË VDEKUR DHE 2 110 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË

ANTIDROGA E POLICISË KONFISKON 31 KILOGRAMË SUBSTANCË NARKOTIKE

MASHTI PLANIFIKON QË MËSIMI TË FILLOJË NË SHKOLLA

EKONOMI



KUFIZOHET VEPRIMTARIA E GASTRONOMISË

ATK-JA LARGON NGA PUNA DY ZYRTARË PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS

SPORT



RAMADANI: EDICION I SUKSESSHËM PËR LLAPIN, KËRKOJMË SUKSESE TË REJA

BE-ja do të dërgojë mision monitorues për zgjedhjet lokale në Kosovë

FAQE 7



Mavraj: Hashim Thaçi është meritore për historinë e Kosovës. Nuk mund ta nxjerrë askush nga historia

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

F. 12

MASHTI planifikon që mësimi të fillojë në shkolla



Prishtinë, 18 gusht - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) e Kosovës është duke planifikuar që viti i ri shkollor të fillojë me pjesëmarrje fizike në shkolla dhe me mësim të rregullt. Aktualisht janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit shkollor, që nis më 1 shtator, thuhet në një përgjigje të kësaj ministrie dërguar "Radios Evropa e Lirë". Edhe përfaqësues të Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) thonë se

mësimdhënësit janë të gatshëm që ta fillojnë procesin mësimor në shkolla. Kryetari i kësaj sindikate, Rrahman Jasharaj, megjithatë thotë se kjo varet nga situata epidemiologjike me koronavirus. Por, për të siguruar një kthim të sigurt në shkolla, MASHTI, SBASHK-u dhe Këshilli i Prindërve u kanë bërë thirrje mësimdhënësve dhe prindërve që të vaksinohen kundër sëmundjes Covid-19. Jasharaj thotë se përpjekjet e të gjitha institucioneve të arsimit në nivel lokal dhe qendror janë që

nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme vitin e ri shkollor ta nisin me prani fizike në shkolla. "Për momentin ne mbesin të vendimi i MASHTI-it që viti i ri shkollor të fillojë në institucionet arsimore. Por, e gjitha varet nga situata e përgjithshme në nivel vendi me të infektuarit me sëmundjen Covid-19, sidomos me variantin 'Delta'. I mbetet Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShPK) dhe Ministrisë së Shëndetësisë që ta analizojnë mirë situatën dhe ta japin vendimin e fundit", thotë ai për "Radios Evropa e Lirë".

Rama: Pritja e afganëve, detyrim ndaj miqve në nevojë

IRANË, 18 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, thotë se është shqetësuese të lexosh që Shqipëria po i strehon të arraturit nga Afganistani vetëm se po kërkojnë Shtetet e Bashkuara, teksa u është përgjigjur zërave kritikë në vend për këtë veprim. "Është kaq shqetësuese të lexosh se Shqipëria po i strehon afganët vetëm sepse na kërkoi ShBA, pasi është qesharake t'ua kthesh kurrizin atyre dhe të fajësosh

vetëm ShBA-në. Ne të gjithë ishim atje si NATO dhe këta njerëz ishin atje për ne, që besonin në idealet mbi të cilat qëndrojnë ShBA dhe BE", shkruan Rama në rrjetin social "Twitter". Ai thekson se Shqipëria po e bën këtë jashtë përgjegjësisë së saj si një vend i NATO-s, por si një borxh dhe detyrim ndaj "traditës shqiptare dhe të kaluarës sonë si refugjatë". "Shqipëria po e bën atë jashtë përgjegjësisë së saj si një vend i NATO-s dhe për shkak të

asaj që jemi. Ne mund të mos jemi të pasur, por ua kemi borxh miqve tanë afganë në nevojë, dhe i detyrohemi traditës sonë, të kaluarës sonë të afërt si refugjatë dhe, gjithashtu, për kujtesën që fëmijët tanë do të trashëgojnë. Largimi nga këto vlera themelore më të mira tona, të historisë sonë dhe i idealeve që bota demokratike supozohet të promovojë jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra, është turp", tha Rama.



Presidenti afgan ka shkuar në Emiratet e Bashkuara Arabe



Kabul, 18 gusht - Presidenti i Afganistanit, Ashraf Ghani, gjendet në Emiratet e Bashkuara Arabe, pasi u largua nga vendi më 15 gusht sapo militantët talebanë hynë në kryeqytetin Kabul. "Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar e Emirateve të Bashkuara Arabe mund të konfirmojë se për arsye humanitare, Emiratet e Bashkuara Arabe kanë mirëpritur presidentin Ashraf Ghani dhe familjen e tij", thuhet në një njoftim të ministrisë që u publikua në faqen zyrtare të

këtij institucioni më 18 gusht. Ghani, që vetëm disa ditë më parë ishte zotuar se nuk do të largohej nga vendi, më 15 gusht iku pa u vërejtur, në orët më të nevojshme të vendit të tij. Disa orë pasi u largua, Ghani shkroi në "Facebook" se ai u largua nga shteti për të parandaluar "gjakderdhje". Disa media raportuan se ai fillimisht udhëtoi për në Takhikistan ose Uzbekistan, edhe pse të dyja këto shtete mohuan një gjë të tillë përpara se të udhëtonte drejt një shteti të tretë

të panjohur. Që nga e diela nuk dihej vendndodhja e tij. Ikja e Ghanit nga Kabuli, teksa qyteti pa rezistencë ra në duart e talebanëve, shënoi fundin e trazuar, të polarizuar të shtatë vjetëve të tij në pushtet. Talebanët filluan pushtimin e vendit që prej se nisën ofensivën ushtarake, e cila përkoi edhe me nisjen e tërheqjes së trupave të huaja më 1 maj. Grupi militant mori nën kontroll shumë qytete të vendit brenda një jave derisa forcat qeveritare u dorëzuan ose u tërhoqën.

Afganët arrijnë në Shkup deri në fund të javës

SHKUP, 18 GUSHT - Deri në fund të javës 450 afganë pritet të arrijnë në Maqedoninë e Veriut, ka bërë me dijetëmërkurën (18 gusht) Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Ardha e tyre do të varet nga rrethanat në Aeroportin e Kabulit. "Maqedonia e Veriut ishte ndër vendet e para, nëse jo e para që u bashkua me Shtetet e Bashkuara dhe ofroi ndihmë për këta njerëz në rrezik nga ardhja e regjimit taleban në

Afganistan", tha zëdhënësi i qeverisë, Muhamet Hoxha. Sipas njoftimit të qeverisë, "njerëzit që do të vijnë në Maqedoninë e Veriut janë të punësuar në misione humanitare dhe paqeruajtëse ose janë anëtarë të familjeve të tyre, pastaj aktivistë të të drejtave të njeriut, gazetarë, përkthyes, studentë, bursistë dhe qytetarë që kanë mbështetur forcat aleate të NATO-s në Afganistan për 20 vjetët

e fundit, përfshirë ushtrinë maqedonase". Ata do të akomodohen në hotele dhe motele, ndërsa shpenzimet do të mbulohen nga Shtetet e Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Sipas qeverisë, afganët që mbërrijnë në Maqedoninë e Veriut më pas do të udhëtojnë në Shtetet e Bashkuara ose vende të tjera si destinacion i tyre përfundimtar.



Mavraj: Hashim Thaçi është meritator për historinë e Kosovës. Nuk mund ta nxjerrë askush nga historia

PRISHTINË, 18 GUSHT - Profesori universitar, publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, e ka cilësuar ish-presidentin dhe ish-udhëheqësin e UÇK-së, Hashim Thaçi, një burrë që mban fjalën dhe ia ka njohur meritat për çlirimin e Kosovës.

Mavraj në një rrëfim për emisionin "Pressing" në T7 ka folur për figurën e Hashim Thaçit, të cilin e ka njohur që herët dhe ka mbajtur raporte të mira gjatë gjithë kohës. "Është burrë. Është burrë, meqenëse ti po më pyet direkt. Po, po. Jo, jo. Nuk mbaj mend që ka devijuar nga ky qëndrim. Është meritator për historinë e Kosovës. Nuk mund ta nxjerrë askush nga historia sepse është aty", ka thënë Mavraj.

Ai, gjithashtu, ka thënë se në aspektin makroekonomik, këta ministra mburraveçë duhet ta dinë se në vitin 2007 Hashim



Thaçi e mori buxhetin 700 milionë dhe e rriti mbi 2 miliard në vitin 2014. Ndërsa, sipas tij, qeveria e sotme nuk do të arrijë ta bëjë kurrë një rritje të tillë.

Mavraj gjatë kësaj interviste nuk e ka fshehur dëshpërimin e tij me ngathtësinë e qeverisë Kurti. "Jam

pak i dëshpëruar, sepse po ec shumë ngadalë dhe po humbin vitet. Dhe s'janë vite të tij, por janë vite të Kosovës", ka thënë ai. Mavraj ka folur edhe për mosangazhimin e tij në jetën politike. Ai ka theksuar se refuzimin për përfshirje në

politikë e ka parë si refuzim ndaj hyqymetit. Mavraj ka thënë se ofertat për t'u përfshirë në politikë kanë nisur dy ditë para bombardimeve të NATO-s e nuk janë ndalur deri në vitet e fundit. "Është njëfarë refuzimi për hyqymetin, edhe pse ky

hyqymeti është i yni. Është qëllimi për të qëndruar larg pushtetit dhe parasë. Ofertat për mua s'kanë munguar kurrë, deri në këto ditët e fundit. Fillojnë diku dy ditë para bombardimeve të NATO-s, atëherë kur ishte Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe kanë vazhduar deri në qeverinë paraprake", ka thënë Mavraj.

Ai ka shtuar se ofertat kanë qenë gjithmonë për pozita të larta. "Gjithmonë kanë qenë oferta për poste të larta, ministër ose deputet", ka thënë tutje Mavraj. Ai ka treguar se qëllimi i tij ka qenë që të mbetet anonim, por lëshimi më i madh që ka mundur të bëjë, ka qenë futja në media. "Qëllimi ka qenë që para luftës që të mbetem person tërësisht anonim. Maksimumi që ia kam lejuar vetes ka qenë që të kyçem në media për t'i mbrojtur ushtarët e UÇK-së", ka theksuar Mavraj.

Haradinaj viziton në Burojë prindërit e Thaçit, u jep medalje

"Përtej dallimeve politike, besoj fuqishëm në drejtësinë ndërkombëtare, pastërtinë e luftës sonë dhe pafajësinë e të gjithë bashkëluftëtarëve, në këtë rrafsh edhe të Hashim Thaçit", ka deklaruar ish-kryeministri Ramush Haradinaj gjatë vizitës që u ka bërë të mërkurën prindërve të ish-presidentit Hashim Thaçi në Burojë të Skenderajt

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

SKENDERAJ, 18 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vizituar të mërkurën në Burojë të Skenderajt prindërit e ish-presidentit Hashim Thaçi. Haradinaj prindërve të Thaçit u ka dhënë medaljen "Me besim në Zot, atdhe e shtet" për kontribut të

jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare. "Sot kisha nderin që me bashkëpunëtorë ta vizitoj familjen e Haxhi dhe Hyre Thaçit, prindërit e presidentit Hashim Thaçi. Njëherësh për ta kam ndarë medaljen 'Me besim në Zot, atdhe e shtet' për kontribut të jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare. Themeli i lirisë dhe shtetit të Kosovës është lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,



udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se luftë më të drejtë, më të pastër e më fisnike, për çlirim nga pushtimi i egër milloshëviqian, nuk do të njohë asnjëherë njerëzimi. "Përtej dallimeve politike, unë besoj fuqishëm në drejtësinë ndërkombëtare, pastërtinë e luftës sonë dhe pafajësinë e të gjithë bashkëluftëtarëve, në këtë rrafsh edhe të Hashim Thaçit", ka deklaruar ish-kryeministri Ramush Haradinaj.

Në këtë vizitë liderin e AAK-së e shoqëronte edhe kandidati për kryetar të Skenderajt nga radhët e PDK-së, Sami Lushtaku.





SHTOHEN KRITIKAT NDAJ QEVERISË PËR MENAXHIM TË KEQ TË PANDEMISË

Kërkohet dorëheqja e Arben Vitisë

Rritja enorme e rasteve me Covid-19 në vend dhe zyrtarizimi i kandidaturës së Arben Vitisë për kryetar të komunës së Prishtinës ka shtuar zërat që ky i fundit të dorëhiqet nga posti i ministrit të Shëndetësisë. Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK) dhe përfaqësuesit e opozitës kanë kërkuar nga Vitia ta lirojë detyrën e ministrit. Sipas tyre, Ministrinë e Shëndetësisë duhet ta marrë në menaxhim dikush i cili është i përkushtuar për menaxhimin e pandemisë dhe për zgjidhjen e problemeve të shumta që kanë pacientët e Kosovës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 GUSHT - Në kohën kur në Kosovë për çdo ditë po infektohen më shumë se 1 000 qytetarë me Covid-19, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka zyrtarizuar kandidaturën e tij për kryetar të komunës së Prishtinës në zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Kjo ka nxitur përfaqësuesit e pacientëve dhe ata të opozitës që ta kërkojnë largimin nga detyra e ministrit

Arben Vitia. Sipas tyre, menaxhimi i pandemisë është larg standardit të dëshiruar.

Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK) ka kërkuar nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, që ta lirojë detyrën pasi është përcaktuar për një rrugëtim të ri politik. Përmes një komunikate për media, PRAK-ja ka theksuar se Ministrinë e Shëndetësisë duhet ta marrë në menaxhim dikush i cili është i përkushtuar për zgjidhjen e problemeve të

shumta që kanë pacientët e Kosovës. "Meqenëse ministri Vitia është përcaktuar për një rrugëtim të ri politik, situata me pandeminë është në krizën më të thellë dhe sistemi shëndetësor ka probleme enorme që janë vështirë të zgjidhshme edhe për dy mandate. Konsiderojmë se ai duhet ta lirojë detyrën në mënyrë që Ministrinë e Shëndetësisë ta marrë në menaxhim dikush i cili është i përkushtuar për zgjidhjen e

problemeve të shumta që ka pacienti i Kosovës", është thënë në komunikatën për media të Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve.

Sipas kësaj shoqate, rritja e shpejtë e numrit të rasteve me Covid-19 është shkaktuar si rezultat i neglizhencës së institucioneve të cilat nuk kanë marrë masa proporcionale në raport me rrezikun që kanosej dhe nuk kanë monitoruar ato pak masa që kishin mbetur aktive. "Tashmë është e kuptueshme se Covid-19 është një trend global dhe se qeveritë e vendeve të ndryshme vetëm mund t'i zvogëlojnë pasojat, por jo ta ndalin atë. Situatën me menaxhimin e pandemisë Covid-19 asnjë Qeveri e Kosovës nuk e ka pasur në kontroll dhe pasojat kanë qenë shumë të mëdha. Kjo vërehet edhe me rritjen e numrit të

rasteve të vdekjes sipas Agjencisë së Statistikave. Gjithashtu, kjo shihet edhe në bazë të disa hulumtimeve të cilat tregojnë se afër 50 për qind e qytetarëve e kanë kaluar Covid-19, e në evidencat shtetërore figurojnë shumë më pak të infektuar që nga fillimi i pandemisë", ka vlerësuar PRAK-u.

Kjo shoqatë ka bërë me dije se menaxhimi i pandemisë është larg standardit të dëshiruar. "Përkundër faktit që Covid-19 ka marrë fokusin e Ministrisë së Shëndetësisë, duke lënë anash problemet e krijuara ndër vite në sektorin e shëndetësisë, megjithatë menaxhimi i pandemisë është larg një standardi të dëshiruar. PRAK-u konsideron se ministri i Shëndetësisë, z. Vitia, ka kohë që menaxhimin e pandemisë është dashur ta kalojë te vartësit

e vet dhe t'i kthehet rolit të vet si ministër në menaxhimin e sistemit shëndetësor", është thënë në reagimin e Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve në Kosovë.

Edhe ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka kërkuar dorëheqjen e ministrit Vitia. "Rekord i zi. Sot 2 110 raste të reja me Covid-19 dhe katër të vdekur. N'dorë t'Zotit! Qeveria e praktikantëve po vazhdon me avazin e vjetër; krejt për pushtet e asgjë për shëndet. U shpreh ngushëllime

më të singerta familjarëve për humbjen e më të dashurve të tyre si dhe u uroj shërim sa më të shpejtë të gjithë të infektuarve", ka shkruar Zemaj në profilin e vet në "Facebook", duke ftuar qytetarët që të vaksinohen. "Të dashur qytetarë, edhe pse kjo qeveri tashmë ka dështuar e menaxhimi ka degraduar, kurdo që t'ju vijë mundësia e parë ju lutem vaksinohuni. Në të njëjtën kohë, ne të gjithë duhet të vazhdojmë t'i respektojmë rekomandimet e

Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Mbani maskat! Respektoni distancën! Mbani higjienën!", ka shkruar Zemaj.

Kurse deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Bekim Haxhiu, ka kërkuar që Arben Vitia të dorëhiqet nga pozita e ministrit të Shëndetësisë apo të shkarkohet nga kryeministri Albin Kurti.

Sipas tij, Albin Kurti dhe Arben Vitia po dezertojnë nga detyrat dhe përgjegjësitë që kanë

marrë në pikun më të lartë të pandemisë Covid-19. "Albin Kurti me kandidimin e Arben Vitisë për kryetar të Prishtinës po tregon qartë se po i braktis 90.52 për qind të qytetarëve të pavaksinuar, sepse lufta për pushtet është prioriteti i tij dhe jo beteja me pandeminë Covid-19 dhe vaksinimi i qytetarëve. Shëndeti dhe jeta e qytetarëve nuk janë prioritet për Albin Kurtin dhe Arben Vitinë, por kolltuku i pushtetit të kryetarit të komunës së Prishtinës. Kandidimi i Arben

Vitisë paraqet fytyrën e vërtetë të Albin Kurtit, që për të arritur në kolltukun e pushtetit është në gjendje të shkelë mbi shëndetin dhe vdekjet nga Covid-19", ka shkruar Haxhiu. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se brenda 24 orëve të fundit, nga 10 258 mostra të testuara, pozitivë me koronavirus kanë dalë 2 110. Gjatë kësaj periudhe kohore janë regjistruar edhe katër viktima nga koronavirusi i ri. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 12 159.

VAZHDON TRENDI I PËRHAPJES SË PANDEMISË NË KOSOVË

Katër të vdekur dhe 2 110 raste të reja me Covid në Kosovë



AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

Nga 10 258 testime, 2 110 qytetarë kanë dalë pozitivë me virusin Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar katër raste të vdekjes. Në total numri i rasteve aktive është 12 159. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës sërish u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen, duke thënë se varianti "Delta" është shfaqur me një shpërthim rapid në shumë shtete të botës dhe në Kosovë

fatale e që, fatkeqësisht, preken edhe fëmijët. "Qytetarë të dashur! 'Delta' varianti është shfaqur me një shpërthim rapid në shumë shtete të botës dhe në Kosovë! Bartet shumë shpejt prej një personi në dhjetëra persona të tjerë me pasojë që në të shumtën e rasteve mund të jenë fatale e që, fatkeqësisht, preken edhe fëmijët!", ka vlerësuar instituti, duke i ftuar qytetarët që t'i respektojnë masat kundër Covidit. "Rastet pozitive me SARS CoV-2 janë në rritje në mënyrë rapide me variantin 'Delta' i cili është dominues! Masat rigorozë të ndërmarra dhe zbatimi i tyre nga çdo qytetar i Republikës bashkë me masat tashmë të njohura: bartja e maskave, mbajtja e distancës dhe mbajtja e higjienës, do të arrijnë efektin e vet në uljen e lakores, por ju lutemi të besoni se masa më

efikase në luftë kundër Covid-19 është vaksinimi!", ka vlerësuar IKShPK-ja. Ky institut u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të marrin vaksinën kundër Covidit. "Vaksinohuni! Vaksinimi kundër Covid-19 shpëton jetë! Personat e pavaksinuar janë brenga jonë më e madhe! Vaksinimi është metoda më e mirë, më e lirë dhe me efikasë në luftë kundër Covid-19! Vaksinimi zgjon mbrojtjen natyrore të trupit tonë për të krijuar rezistencë ndaj infeksioneve specifike dhe e fuqizon sistemin imunitar. Vaksinimi parandalon vdekjet dhe komplikimet e rënda, të cilat kërkojnë shtrirjen e pacientit në spital", është thënë në njoftimin e IKShPK-së. Gjatë 24 orëve të fundit nga Policia e Kosovës janë shqiptuar mbi 700 gjopa për persona juridikë dhe persona fizikë për mosrespektim të masave.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 GUSHT - Kosova ka shënuar tjetër rekord të zi sa iu përket rasteve të infektimit me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit 2 110 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me koronavirus, ndërsa janë raportuar katër raste të vdekjes. "Nga 10 258 testime, 2 110 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar

katër raste të vdekjes. Sot janë shënuar 130 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve është 106 408. Në total numri i rasteve aktive është 12 159", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë ka treguar se mbi 20 mijë qytetarë janë vaksinuar gjatë 24 orëve të fundit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 20 358 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 622 068 doza të vaksinës.

Deri më sot 215 329 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë", është thënë në njoftimin e MSh-së.

Pas rritjeve të rasteve me Covid, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka theksuar se varianti "Delta" është shfaqur me një shpërthim rapid në shumë shtete të botës dhe në Kosovë.

IKShPK-ja ka njoftuar se varianti "Delta" bartet shumë shpejt prej një personi në dhjetëra persona të tjerë me pasojë që në të shumtën e rasteve mund të jenë

Daut Haradinaj takon kryetarin e Bashkisë së Tiranës

TIRANË, 18 GUSHT (ER) - Kandidati për kryetar të Prishtinës nga radhët e AAK-së, Daut Haradinaj, ka takuar të mërkurën kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion

Veliaj. "Takim vëllazëror me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj. Është kënaqësi e veçantë që të shkëmbejmë ide dhe përvoja me Erionin që Tiranën e ka

kthyer në kryeqytet konkurrent me vendet e zhvilluara", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se bashkëpunimi i dy vendeve

është në vazhdimësi, dhe jo vetëm në nivel takimesh. "I çdoditshëm dhe praktik për të mirën e kryeqyteteve tona shqiptare", ka shkruar Daut Haradinaj.



Haziri viziton resortin më të bukur kullën e Gjinajve që u dëmtua nga zjarri

GJILAN, 18 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar të mërkurën resortin më të bukur të Karadakut dhe më gjerë që, fatkeqësisht, një aneks i tij është dëmtuar nga zjarri ditë më parë, për të cilin ka thënë se duhet të gjitha institucionet me veprime konkrete të jenë afër pronarëve Metush dhe Nadire Zymberi. "Kam vizituar resortin më të bukur dhe të jashtëzakonshëm, kullën e Gjinajve, që për bazë ka traditën, kulturën e Karadakut dhe shqiptarëve kudo që jetojnë. Ky resort është ndërtuar nga Metush dhe Nadire Zymberi, që udhëheqin edhe kompaninë e njohur Menakon në Gjilan. I falënderoj shumë për investimin, por motivi i vizitës ka qëlluar në fatkeqësi dhe në këtë ditë të rëndë kam dashur të jem afër familjes Zymberi, për ta përballuar humbjen e madhe që shkaktoi zjarri duke përfshirë restorantin, kuzhinën dhe një pjesë të madhe të këtij investimi, të jashtëzakonshëm që ka qenë

një nga veprat më të mëdha private të ndërtuara në regjionin e Gjilanit", ka thënë Haziri.

Ai ka konfirmuar se do të jetë afër investitorëve duke bërë thirrje që të sanohet gjendja, të hulumtohen shkaqet dhe të gjendet mundësia e sanimit të kësaj fatkeqësie. "Duhet të gjejmë mundësi dhe forma që të përballohet kjo fatkeqësi dhe ky dëm i madh material i kullës së Gjinajve. Të bëhet zgjidhje e shpejtë dhe normalizim i punës, sepse direkt dhe indirekt preket punësimi i rreth 100 qytetarëve, që në forma të ndryshme janë të lidhur me këtë resort. Zjarri që ka kapluar kulmin, si pasojë e energjisë elektrike, e bën më të rëndë dhe më fatkeq këtë rast. Besoj shumë se KEDS-i, institucionet e qeverisë dhe institucionet e tjera, do t'i gjenden afër sikur komuna e Gjilanit, këtij investitori sepse është obligim që të hulumtohet shkaktari i fatkeqësisë së zjarrit që në këtë rast është rryma", ka thënë Haziri.



Gjini shkarkon drejtorin e Nismës në Gjakovë, Fazli Hoxha thotë se ndali ndërtimet pa leje



GJAKOVË, 18 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka liruar nga detyra e drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese, Fazli Hoxha, i cili është kryetar i Degës së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë. Partia e Fatmir Limajt ka qenë në bashkëqeverisje me AAK-në në Gjakovë me dy drejtori.

Hoxha përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se janë dy arsye të shkarkimit të tij që e kanë penguar Ardian Gjinin. "Sot nga kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, pranova një vendim në të cilin thuhet se lirohem nga detyra e drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese. E kuptoj z. Gjini pse

ka ardhur deri te ky vendim. E para, atij i ka penguar kandidimi im për kryetar komune në zgjedhjet e 17 tetorit dhe, në anën tjetër, fuqizimi i Nismës Socialdemokrate që po ndodh në Gjakovë. E dyta, i ka penguar ndalja e ndërtimeve pa leje në Gjakovë, nga një grup i caktuar që insiston për t'u shkelur ligjet e ndërtimit. Këtë gjë unë nuk e bëj. Zotimi im që nga dita e parë kur kam marrë pozitën e drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese ka qenë dhe vazhdon të jetë respektimi i ligjit. Megjithatë, e kuptoj se gara për kryetar të Gjakovës nuk e lë Ardian Gjinin në komoditetin e dëshiruar. Shihemi më 17 tetor", ka shkruar Hoxha.

Bulliqi inspekton punimet për renovimin e objekteve banesore

PODUJEVË, 18 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Bujar Hasani,

inspektojnë punimet për renovimin e objekteve banesore në qytet. "Kemi filluar ndërtesën përballë QKMF-së, objekt me kushte të rënda e i paprekur ndonjëherë nga dora e shtetit. Ky objekt do të

fasadohet dhe do të bëhen edhe intervenime të tjera të nevojshme", ka thënë kryetari Bulliqi.

Në kuadër të projektit për meremetim të objekteve banesore do të trajtohen edhe

objekte të tjera, ndërsa në to do të intervenohet në rregullimin e pullazeve të vjetruara, fasadim, izolim, rregullim të ndriçimit nëpër hyrje dhe korridore si dhe, sipas nevojës, ndërrimi i dritareve ndriçuese.



BE-ja do të dërgojë mision monitorues për zgjedhjet lokale në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) i është përgjigjur pozitivisht ftesës së presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, që një mision evropian të bëjë monitorimin e zgjedhjeve lokale në Kosovë të caktuara për 17 tetor. Në muajin qershor presidentja Osmani kishte kërkuar nga presidenti i Parlamentit Evropian, David Sassoli, si dhe përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Joseph Borrell, që të dërgojnë një mision monitorimi të zgjedhjeve.

Presidenca ka njoftuar më 18 gusht se ka pranuar përgjigjen nga ana e këtyre dy zyrtarëve në të cilat thuhet se Parlamenti Evropian konfirmon gatishmërinë për të marrë pjesë në monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë, ndërsa përfaqësuesi i lartë, Borrell, do të bëjë emërimin e shefit të misionit. "Për dallim nga zgjedhjet e fundit parlamentare, në të cilat Misioni i BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve është përbërë nga një numër i vogël ekspertësh, në

zgjedhjet lokale të vitit 2021 BE-ja do të jetë e pranishme me mision të plotë të vëzhgimit të zgjedhjeve në Republikën e Kosovës deri në certifikimin e rezultatit zgjedhor", thuhet në njoftimin e zyrës së presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale të 17 tetorit kanë aplikuar 94 subjekte politike, prej tyre 32 parti, një koalicion, 35 iniciativa qytetare dhe 26 kandidatë të pavarur.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka njoftuar se numri i përgjithshëm i kandidatëve që kanë aplikuar është 4 920, prej tyre 165 për kryetarë komunash dhe 4 757 për kuvende komunale. "Përfaqësuesi i Lartë, Borrell, ka shprehur besimin se raporti përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve do të ndihmojë në mbështetjen e përpjekjeve të ardhshme të nevojshme për reformën zgjedhore duke adresuar rekomandimet e mbetura të vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së", thuhet në një deklaratë të shefit të zyrës së BE-së në Prishtinë, Tomas Szunyog.



Antidroga e policisë konfiskon 31 kilogramë substancë narkotike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 GUSHT - Antidroga e Policisë së Kosovës në rajonin e Prishtinës ka konfiskuar 31 kilogramë substancë të dyshuar narkotike dhe ka vënë në pranga dy persona të dyshuar për blerje, posedim apo shpërndarje të paautorizuar të saj. "Policia e Kosovës në luftën e saj për identifikimin dhe parandalimin e dukurisë së posedimit, përdorimit apo shitblerjes së substancave narkotike, përmes zyrtarëve policorë të anti-drogës, ka realizuar dje një operacion policor me ç'rast janë arrestuar dy persona të dyshuar dhe janë konfiskuar 31 kilogramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë. Operacioni policor është ndërmarrë dje më 17.08.2021, në Komoran të Drenasit, pas pranimit të informacioneve dhe hetimeve të zhvilluara nga njëra rajonale

e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve në Prishtinë, në konsultim dhe bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia ka njoftuar se në këtë operacion është konfiskuar vetura "Passat" me targa vendore, pronë e të dyshuarit mashkull (shtetas i Kosovës), në të cilën janë gjetur dhe konfiskuar dy thasë të mbushur me 31 kilogramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë. "Po ashtu, është konfiskuar edhe vetura (me targa të Shqipërisë) e personit të dyshuar mashkull shtetas i Shqipërisë, dy celularë, para 1 050.00 euro dhe 13 500.00 lekë. Me urdhër të prokurorisë është realizuar edhe një bastisje në lokacionin e të dyshuarit mashkull kosovar të sipërcekur në rast dhe është sekuestruar edhe një veturë tjetër (e tretë) në të cilën janë gjetur mbetje të vogla të substancave narkotike.



Personat e arrestuar nga Policia e Kosovës me vendim të prokurorit

kujdestar janë dërguar në mbajtje për procedura të

mëtejme", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Komuna e Prishtinës dhe komuna e Bursës në Turqi vazhdojnë bashkëpunimin

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Nën kryetari i komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion nga komuna e

Bursës së Turqisë, respektivisht kryetarin e kësaj komune, Alinur Aktas, shoqëruar nga ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çagrı Sakar, si dhe përfaqësues

të parlamentit turk nga Bursa. Në këtë takim u diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy komunave duke rikonfirmuar marrëveshjen e

vitit 2011, si dhe duke vazhduar punën për avancimin e shkollave profesionale, menaxhimin e hapësirave publike dhe këmbimin kulturor.



ATK-ja largon nga puna dy zyrtarë për mosrespektim të orarit të punës

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER) - Pas verifikimit të të gjitha fakteve dhe shterjes së të gjitha procedurave ligjore, Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) më 12 gusht 2021 ka marrë vendim për shqiptimin e tri masave disiplinore ndaj tre zyrtarëve të

ATK-së. Masat disiplinore janë shqiptuar në mungesa të paarsyeshme në punë mbi pesë ditë. "Lidhur me shkeljet e rënda të konstatuar nga Komisioni Disiplinor, dy zyrtarëve u është shqiptuar masa disiplinore largimi nga Shërbimi Civil në përputhje

me nenin 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Ligjit nr. 06/114 për Zyrtarë Publikë. Ndërsa zyrtarit tjetër i është shqiptuar masa disiplinore për shkelje të rënda, ndalim i ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 47, paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 të Ligjit nr.

06/L-114 për Zyrtarët Publikë. ATK është e zotuar për zero toleranca ndaj shkelësve të ligjit, ndërsa llogaridhënia dhe transparenca mbesin synimet tona për rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucionit të Administratës Tatimore të Kosovës", ka njoftuar ATK-ja.



Kufizohet veprimtaria e gastronomisë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 GUSHT - Kryetari i Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, Hysen Sogojeva, i shoqëruar nga drejtori i Departamentit të Estradës në kuadër të OHTK-së, Afrim Muçiqi dhe Driton Hoti, drejtor i Departamentit të Sallave të Dasmave, kanë mbajtur një takim me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia. Ky takim kishte qëllim kryesor diskutimin rreth

gjendjes pothuajse alarmante të krijuar së fundmi me ngritjen e rasteve të infektuarve me Covid-19.

Ministri Vitia dhe përfaqësuesit e OHTK-së u zotuan se do të përpiqen të gjejnë një mundësi që pa u dëmtuar askush dhe duke respektuar masat të arrihet deri te zvogëlimi i sërishëm i numrit të infektuarve me këtë virus.

Në këtë takim u vendos që gastronomia dhe hoteleria në përgjithësi të punojnë deri në

orën 22:30. Në sallat e dasmave të ketë më së shumti 150 persona. Pronarët e sallave të dasmave janë të obliguar të caktojnë një person i cili do t'u kërkojë të ftuarve njëherë nga dëshmitë: testin negativ për Covid-19 jo më të vjetër se 72 orë ose dëshminë që personi është vaksinuar së paku me dozën e parë të vaksinës.

Ndërkaq restorantet ditore, kafiteritë, hotelet dhe lokale të tjera të ngjashme duhet të punojnë deri në orën 22:30. "Në qendrat tregtare është

obligative mbajtja e maskës si dhe mund të punojnë deri në orën 22:30 dhe nuk ka kufizime të lëvizjes", është thënë në njoftimin e OHTK-së.

Nga data 20 gusht hyrja në ambientet e klubeve të natës, diskotekave dhe ambientet ku mbahen ahengjet, grumbullimet, tubimet masive, të cilat kanë kapacitet mbi 100 persona, si dhe organizimi i këtyre aktiviteteve, lejohet vetëm nëse pjesëmarrësit kanë një nga dëshmitë: Certifikatën e vaksinimit për vaksinimin e

plotë ose marrjen e një doze të vaksinës kundër Covid-19, ose dëshminë që janë negativë për Covid-19. Ky vendim hyn në fuqi më 20 gusht dhe vlen deri më 1 shtator.

Ministri Vitia dhe përfaqësuesit e OHTK-së u pajtuan se do të vazhdojnë takimet dhe do të jenë në kontakt të vazhdueshëm dhe secili hap do të merret bashkërisht. Ata, po ashtu, u pajtuan se nëse pas datës 1 shtator bie numri i infektuarve, atëherë masat lirohen sërish dhe e kundërta.



Ekipi i KEDS-it sulmohet në Prizren teksa po kryente detyrën zyrtare

Prizren, 18 gusht (ER) - Një ekip i KEDS-it është sulmuar më 17 gusht në Prizren teksa po kryente detyrën zyrtare. Për rrjedhojë, një nga punëtorët ka marrë lëndime trupore. Ai pas tretmanit mjekësor është duke u shëruar në shtëpi. Policia e Kosovës është duke u marrë me rastin. "KEDS-i dënon fuqishëm këtë veprim, përderishte ne si kompani presim nga organet e rendit dhe të drejtësisë ta kryejnë punën e tyre dhe ata që bëjnë veprime të tilla ta marrin dënimin e merituar.

Rastet e tilla paraqesin pengesa të mëdha në kryerjen e detyrave për punëtorët tanë të cilët kanë mision furnizimin me energji elektrike të qytetarëve të vendit. Secili punëtor yni është i përkushtuar t'i kryejë detyrat e veta zyrtare, ndërsa presim nga të gjitha hallkat e shoqërisë që punëtorëve tanë t'ua lehtësojnë punën, pra të bashkëpunojnë për të gjitha çështjet që ndërlidhen me ta, kur dihet rëndësia jetike e furnizimit me energji elektrike për popullin, e

sidomos për ekonominë e Kosovës", është thënë në reagimin e KEDS-it.

KEDS-i ka kërkuar nga secili konsumator që t'i kryejë detyrat dhe obligimet e veta në mënyrë që të mos sulmohet sistemi, por ai të avancohet tutje si një e mirë e përbashkët. "Kjo është rruga e vetme përmes së cilës mund të ecim përpara. Rastet e tilla paraqesin vetëm vështirësi, prandaj nuk guxojnë të përsëriten më", thuhet në reagimin e KEDS-it.





NGA: ANDREAS DUSHI

Dy bij, dy rrëfime për dy dashuri

Kur lexojmë *Jeto për ta treguar*, episodet "magjike" të 100 vjet vetmi marrin një tjetër trajtë, pasi vëmë re se janë momente e incidente të jetuara nga vetë Gabo, shndërruar më pas në letërsi. Por jo vetëm 100 vjet vetmi është magjik nga letërsia e Márquez-it: Gjithçka ai shkroi, krijon te lexuesi përjtimin e magjishëm të një lloj kënaqësie që rrallëherë letërsia ta jep, përfshirë këtu edhe *Dashuria në kohërat e kolerës*, sidomos *Dashuria në kohërat e kolerës*.

Vetë Márquez-i, pasi tregon se si ishin njohur prindërit e tij, thotë se *Historia e këtyre dashurive të kundërshtuara përbënte një çudi për mua kur isha i ri. Ngaqë e kisha dëgjuar sa e sa herë nga goja e prindërve, nga të dy së bashku ose veç e veç, e dija thujse të plotë kur shkrova*

"Gjethurinat", romanin tim të parë, në moshën njëzet e shtatë vjeç, po gjithashtu isha i ndërgjegjshëm se më mbetej shumë për të mësuar në artin e të shkruarit. Që të dy ishin rrëfyes të shkëlqyer, me kujtimin e lumtur të dashurisë, porse arritën të apasionoheshin aq shumë në rrëfimet e tyre saqë, kur më së fundi, pasi i kisha kaluar të pesëdhjetat, vendosa ta përdorja te "Dashuria në kohërat e kolerës", nuk i dalloja dot kufijtë ndarës midis jetës dhe poezisë.^[1]

Një ndër romanet më ikonikë jo veç të Márquez-it, por të gjithë letërsisë botërore, është shkruar duke metamorfizuar lëndën reale të dashurisë së prindërve të tij në lëndë letrare të një dashurie që vijon të tërheqë lexues edhe dekada pas botimit të parë.

Ndërsa tani është djali i

Márquez-it, Rodrigo Garcia ai që merret me dashurinë e prindërve të tij, por jo ashtu sikurse bën i ati. Ai nuk provon ta kalojë në poçari krijuese jetën dhe dashurinë e Gabo-s dhe Mercedes-it, por përkundrazi, e tregon ashtu sikurse ishte, pa asnjë kompleks gjykimi a paragjykimi, kjo e ardhur ndoshta edhe për hir të lirshmërisë së Gabriel Garcia Márquez-it sa herë fliste dhe tregonte për veten.

Janë ditët e tij të mbrame, kur fillon të bëhet i vetëdijshëm se jetës po i vjen fundi. Te kujtimet e tija, shkruan: *Gjer në moshën pesë vjeç, vdekja kishte qenë për mua një fund i natyrshëm që u ndodhte të tjerëve. Kënaqësitë e qiellit dhe mundimet e ferrit më dukeshin thjesht mësim për t'u përmendsh në katekizmin e padre Astetes.*

Ato s'kishin të bënin fare me mua...^[2] Po tani, kur vdekja, si fundi më i natyrshëm i tij është kaq pranë?

Si shumë shkrimtarë, edhe ai është i fiksuar pas humbjes dhe vdekjes, shfaqjes më të madhe të saj. Vdekja si rregullsi dhe parregullsi, si e logjikshme dhe e pakuptimtë, si e pashmangshme dhe e papranueshme.^[3] Kujtimet e tij në trajtë autobiografie, Márquez-i i konceptoi si një triologji; si një rrëfim i gjithë formimit të tij si shkrimtar dhe si njeri. Pjesa e parë mbaron pikërisht në kohën kur u martua me Mercedes-in, gruan që do ta shoqëronte përgjatë gjithë jetës. Nuk i mbaroi, dhe fillin ku kjo dëshirë e tija u këput, e shtrëngon fort Rodrigo. Ai tregon se si, për shembull, një pasdite të vitit 1966 në Qytetin e Meksikos shkoi në dhomën ku mamaja

po lexonte në shtrat dhe e njoftoi se posa kishte mbaruar së shkruari për vdekjen e kolonelit Aureliano Buendia.

"E vrava kolonelin", – i tha i tronditur.

Ajo e dinte se sa i rëndësishëm ishte ai për të dhe të dy qëndruan në heshtje me lajmin e trishtuar.^[4]

Pra, Rodrigo na jep kështu pasqyrimin e Márquez-it në sytë e Mercedes-it dhe jetën e këtyre syve pasi prej tyre rrodhën lotët e vdekjes së të shoqit.

Kemi përballë dy histori dashurie. Njëra, e treguar me mjeshtëri të rrallë nga një bir shkrimtar, duke krijuar një ndër metaforat më të bukura të dashurisë ndërsa tjetra, treguar me sinqeritet të rrallë nga biri i shkrimtarit, duke treguar një ndër realitetet më të bukura të dashurisë. /Gazeta "ExLibris"/



ALBULENA ALIDEMA

Zyrtarizimi i toskërishtes dhe përmbysja e varietetit të elbasanishtes

(Vijon nga numri i kaluar)

Pikërisht, në periudhën që i parapriu Konsultës së Prishtinës, doli në plan të parë funksionimi unifikues dhe separatis për të cilin flet Fosili, unifikues, sepse i bashkonte shqiptarët si komb me një gjuhë të vetme dhe dallues, sepse kjo gjuhë i dallon nga bashkësia gjuhësore (Memushaj 2008: 82).

Edhe pse për akademik Idriz Ajetin, kjo Konsultë u udhëhoq nga ideja qendrore 'një komb një gjuhë letrare' dhe e lidhi ngushtë njësinë e gjuhës me njësinë e kulturës kombëtare shqiptare. Ajo, prandaj unis, në radhë të parë, jo nga gjendja e nga veçoritë e këtij ose atij varianti letrat dialektor, por nga shkalla më e përparuar d.m.th. edhe më e njësuar, që kishte arritur, objektivisht, në atë kohë, gjuha letrare në rrafshin kombëtar (Idriz 2008: 8).

Mirëpo, kjo konsultë, edhe sot, pesëdhjetë vjet pas mbajtjes së saj, u vërtetua se luajti rol formal unifikues të gjuhës, ashtu siç thoshte Idriz Ajeti, por nuk e përfshiu shkallën më të përparuar të gjuhës (dialektin gegë), pra e ndikuar nga rrethanat politike të asaj kohe, ajo ndihmoi për përmbysjen e varietetit të

elbasanishtes si gjuhë unifikuese e të gjithë shqiptarëve, duke e ngritur, në normë, varietetin e toskërishtes.

Për rrjedhojë, që nga viti 1968 e këtej shqiptarët që jetonin në trojet e tyre në ish-Jugosllavi, në bazë të vendimeve të Konsultës së gjerë shkencore të Prishtinës, që u mblodhën në prill të atij viti, filluan ta përdornin gjuhën letrare kombëtare shqipe dhe drejtshkrimin e saj të njësuar.

Por, edhe sot, gjysmë shekulli pas, kjo Konsultë, për shumicën e studiuesve dhe historianëve të gjuhës, por edhe të pjesëzarrësve të saj, privohet nga karakteri politik. Megjithatë, në mesin e gjuhëtarëve ka prej atyre që mendojnë se pjesëzarrësit e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës dhe, sidomos të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, pa të drejtë i mbrojnë këto dy tubime prej kritikëve dhe mohuesve të rëndësisë së tyre shkencore dhe historike kombëtare. Sipas tyre, janë të panevojshme dhe të papranueshme përpjekjet për t'i privuar Konsultën dhe Kongresin prej karakterit të tyre politik, kurse Konsulta Gjuhësore e Prishtinës edhe më shumë se Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Në këtë kontekst, studiuesi

Rexhep Qosja, lidhur me karakterin politik të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës dhe Kongresit të Drejtshkrimit, shtron pyetjen: *si të mos kishte karakter politik? Sipas tij, aktet e krijimit të gjuhës letrare nuk janë festivale të këngëve argëtuese. Te çdo popull evropian, formimi i gjuhës letrare ishte akt, para së gjithash, politik. Me formimin e gjuhës letrare, synohej njësia e kombit, funksionimi i tij, si një tërësi në gjithë hapësirën, në të cilën jetojnë pjesëtarët e tij* (Rexhep 2008: 19).

Për karakterin politik të unifikimit të gjuhës shqipe, por me një këndvështrim ndryshe nga Qosja, shprehet studiuesi Ardian Vehbiu. Duke komentuar vendimet e Komisionit dhe të Kongresit të Drejtshkrimit, Vehbiu (2015) konstaton se: *në vitet 1960-1980, shqipes së lëvruar iu amputua gegërishtja letrare, kinse për hir të njësimi, por, në fakt, për arsye politike dhe ideologjike; kjo na kushtoi shumë shtrenjtë të gjithëve* (Vehbiu 2015).

Në kuadër të diskutimeve të mëvonshme, për nevojën e rishikimit të standardit, sipas Vehbiut, për fat të keq, pas 1990-s, të gjithë ata që i kishin mundësitë dhe

përgatitjen për të rikuperuar shumëçka nga kjo traditë, parapëlqyen të bëjnë zhurmë politike, për rishikimin e standardit, ose humbën kohë me rivendikime dhe argumente populiste, të fokusuara në dialektin dhe në objekte të tjera të një këndvështrimi romantik ndaj gjuhës. Kjo ngjarje e rëndë për kulturën kombëtare, që ishte represioni, shpesh, i dhunshëm i shkoderanishtes letrare, erdhi dhe u shfrytëzua si pretekst - do të thosha me cinizëm - për të kërkuar amatorisht ndryshimin e standardit, si një formë dëmshpërblimi 'kulturor' (Vehbiu 2015).

Në Librin Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, të botuar në vitin 2008, Rexhep Qosja shprehet: *Për njohjen dhe rëndësinë e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, është e nevojshme të dihet se si është shikuar ajo në Serbi, në Shqipërinë shtetërore dhe se si ajo po shikohet sot në Kosovë. Si dëshmi për të përforcuar argumentin e tij, ai merr edhe deklarin e Dobrisa Qosiqit në mbledhjen e 14-të të KQ të LKS-së, të mbajtur në Beograd, më 29 maj të vitit 1968. Këtu, Qosja, sjell në vëmendje se shkrimtari Dobrisa Qosiq, në fjalimin e tij do të përpicej*

t'u bëjë një shqyrtim historik edhe politik, natyrisht, nga aspekti i interesave kombëtare serbe, marrëdhënieve serbo-shqiptare, në të kaluarën dhe në përtashësinë. Sipas Qosjes, *ky është shqyrtimi intelektual, i cili nuk ka hequr dorë nga mitologjia mesjetare dhe koncepti serbomadh për Kosovën. Këtu, ai do ta shqiptojë fjalinë, që do të citohet shumë e shumë herë: Të vërtetën për Kosovën duhet ta shikojmë me zemër dhe për të, të mendojmë ndërgjegjshëm e publikisht*. (Qosja 2008: 19).

Duke qenë në kushte të tilla, nën ndikimin e represionit serb, gjuhëtarët e Kosovës e përqafuluan zyrtarizimin e toskërishtes, duke u larguar nga varieteti i përdorur, në atë kohë, që ishte gegërishtja. Megjithatë, është fakt, se pranimi i toskërishtes, nga ana e gjuhëtarëve të Kosovës, në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës, i bëri shqiptarët me gjuhë standarde.

Por, për Mehmet Elezin, duke votuar për standardin, dijetarët e Kosovës u sollën si shqiptarë e jo si gjuhëtarë. Duke pasur parasysh kohën dhe kushtet, ky ishte një veprim i lartë atdhetar për me e rujtë njësinë kombëtare dhe historia do t'ua mbajë mend, për mirë atyre

(Elezi 2010:85).

Mirëpo, nga ana tjetër, siç shprehet Vehbiu (2017), *ky vendim i elitave kulturore në Kosovë u përdor, në mënyrë demagogjike, prej ideologëve në Tiranë për të mbështetur tezën e tyre subjektive, se fushata për njësimin e gjuhës, frymëzohej drejtpërdrejt nga idealet fisnike të kombëtarizimit shqiptar të Rilindjes* (Vehbiu 2007:26).

Edhe pse, kohë pas kohe, debati shkencor për standardizimin e gjuhës shqipe merr edhe trajta të debateve politike, roli dhe rëndësia e Kongresit të Drejtshkrimit do parë e analizuar nga prizmi dhe konteksti i gjithëmbarshtëm i kombit shqiptar, në etapa të ndryshme të zhvillimit të tij.

Por, kur flasim për ndriçimin e fakteve, që kanë të bëjnë me mënyrën dhe formën e ndërtimit të standardit të gjuhës shqipe, nuk mund të mos themi se zgjedhja e një varianti të tillë nuk u bë duke e pasur parasysh zhvillimin më të madh në botimet letrare artistike, por duke u mbështetur në toskërishten letrare, duke i marrë edhe disa elemente të tija.

Në këtë mes, studiuesja Aljula Jubani, thekson se *ky variant standard i gjuhës shqipe, aq i kërkuar prej kohësh, por edhe i kontestuar, pas krijimit të tij, nga një pjesë e intelektualëve shqiptarë, për shkak të ndërhyrjes së faktorëve jashtëgjuhësorë e politikë në realizimin e tij, u bë variant zyrtar i përdorur në gjuhën administrative, në mjetet e komunikimit publik, në tekstet shkollore dhe shkallë-shkallë filloi të dallohet edhe varianti i folur i tij. Kështu, ky variant i standardizuar, që e nisi rrugën e tij në formën e shkruar, me kalimin e kohës, nisi të bëhet i dallueshëm edhe në formën e folur* (Jubani 2008: 80-82).

Mirëpo, përpjekja, shumëvjeçare, për respektimin e normës gjuhësore, që rezultoi nga Kongresi i Drejtshkrimit, sidomos normës drejtshqiptimore, nuk dha rezultatet e pritura. Brenda hapësirës gjeografike në Kosovë, që nga Kongresi, përqendrimi për respektimin dhe zbatimin e normës gjuhësore të '72-s, më shumë u bë në aspektin e drejtshkrimit sesa në atë të drejtshqiptimit. Pra, norma drejtshkrimore arriti një zbatueshmëri më të madhe, ndërsa norma drejtshqiptimore, edhe sot, pesëdhjetë vjet pas, nuk po arrin të respektohet e të zbatohet as përafërsisht.

Kështu, menjëherë pas luftës në Kosovë (1999) çështja e gjuhës letrare u bë problem themelor i gjuhësisë shqiptare dhe objekt diskutimi mbi rëndësinë e Konsultës dhe Kongresit të Drejtshkrimit. Në të gjithë vorbullën e diskutimeve dhe argumenteve të shumëllojta, askush nuk e moho rëndësinë e këtyre dy mbledhjeve të rëndësishme për gjuhësinë shqiptare. Por, megjithatë, një pjesë e gjuhëtarëve ende vazhdojnë ta shohin Konsultën Gjuhësore të Prishtinës të ndikuar nga rrethanat politike të asaj kohe.

Në këtë kontekst, edhe sot shumë

gjuhëtarë të Kosovës mendojnë se standardi i shqipes u sanksionua në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të mbajtur në Tiranë më 1972. Meqenëse, sipas tyre, vendimet e tij ishin arbitrare e të panevojshme, siç janë të gjitha ndërhyrjet e jashtme në rrjedhën e gjuhës, nga përfundimi i këtij kongresi, një pjesë mbeti e kënaqur, ndërsa pjesa tjetër, kur më shumë, e kur më pak, e kundërshtoi këtë standard (Beqiri 2016:206).

Edhe gjuhëtarë tjetër, Rrahman Paçarizi, kur flet për nevojën e rishikimit të këtij standardi, shprehet: *Mundësitë për ndryshime janë tepër të vogla aktualisht. Fillimisht, duhet të ndryshojë qasja ndaj gjuhës, duhet të adaptohet një qasje shkencore ndaj gjuhës dhe kjo qasje shkencore është, praktikisht, ajo që njihet në sociolinguistikë dhe në teorinë e standardizimit si qasje evolutive, që do të thotë se faza e standardizimit, ende, nuk ka përfunduar dhe standardi duhet të rishikohet. Duhet të matet raporti ndërmjet gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, në kondita të barabarta, në kuptim të domeneve dhe situatave të realizimit gjuhësor dhe vetëm kështu, mund të arrijmë një standard. Më tutje, ai shton se standardi aktual duhet të rishikohet dhe jo të bëhet një standard i ri për shqipen e Kosovës apo për gegërishten. Shqipja ka parakushte tepër të favorshme për të pasur një standard funksional dhe në shërbim të folësve* (Paçarizi 2010:98).

Mirëpo, studiuesi tjetër, Munishi, për çështjen e rishikimit të normës, shprehet: *Me kalimin e kohës, rishikimi i normës është një aktivitet i pashmangshëm, pasi një gjuhë standarde të jetë përdorur për një kohë, në një ambient të caktuar gjuhësor, nga bashkësia folëse e dhënë. Është e natyrshme që edhe këtë aktivitet e përcjellë dhe e mbështet një planifikim gjuhësor dhe një politikë e caktuar gjuhësore, që ndiqet nga elita politike kulturore e atij areali folës, e cila, gjithnjë, ka interesa të caktuara. Rezultati i këtij procesi është norma standarde e përpunuar dhe e mbështetur nga elita, që riplotëson po ato hapësira dhe funksione që i kishte më parë, funksione këto, që, me të vërtetë, i ruan gjithmonë* (Munishi 2016:127).

Tutje, ai shton se rishikimi duhet të merret si një proces rregullues, që garanton vitalitetin e normës së gjuhës standarde në raport me rrethanat e reja shoqërore. Rishikimi i normës, thjesht, duhet t'i përcjellë proceset dinamike që ndodhin në shoqëri dhe në gjuhë (Munishi 2016:127).

Por, Qosja (2008), këta gjuhëtarë, të cilët mbajnë qëndrime lidhur me rishikimin e standardit, i sheh edhe si kundërshtarë politikë, të cilët, sipas tij, *gjoja se dëshirojnë të kenë edhe një komb tjetër dhe për këtë, ai shprehet: Në qoftë se, në një kohë, qëndrimet e tilla janë bërë në emër të një dialekti të gegërishtes, tani, në kohë të fundit, po bëhen në emrin e kombit të ri, që duhet të veçohet nga gjiri i kombit shqiptar-në emrin e kombit kosovar. Ai, më tej, shton: Në kundërshtimet e rëndësishme të kësaj*

Konsulte si edhe të Kongresit të Drejtshkrimit, po ashtu, shfrytëzohet edhe argumenti shkencor, gjuhësor, por për t'u shprehur qëllimi i kundërt politik: ne shqiptarët në Kosovë, kemi tani shtet tjetër, prandaj duam të jemi edhe komb tjetër dhe të kemi gjuhë tjetër standarde (Qosja 2008).

Në këto mendime se gjuhëtarët e Kosovës kanë një mendim të tillë politik, që ta ndajnë gjuhën në dysh, duke e parë si proces politik të ndarjes së kombit. Në Kosovë asnjëherë e më shumë nuk është diskutuar rreth bashkimit të kombit. Por, të gjithë e dimë se shqiptarët e Kosovës duhet ta mësojnë gjuhën standarde vetëm nëpërmjet formave të shkruara, vetëm nëpërmjet librave dhe, natyrisht, të gjithë e dimë, se format e shqiptimit, vendosja e theksit etj., nuk mund të mësohen nëpërmjet gjuhës së shkrimit.

Po ashtu, duke u nisur nga fakti që gjuha nuk është një fenomen i mbyllur, ajo duhet të jetë e hapur dhe dinamike, ngaqë është një proces i gjallë. Edhe shoqëria, edhe individët bartës të gjuhës, ndryshojnë e zhvillohen, pra, janë të hapura.

Në këtë kontest, Belluscio shprehet: *Evolucioni gjuhësor paraqet shumë ndryshore dhe transformimet në gjuhë mund të jenë të ndryshme, në shumicën e rasteve edhe të pajustificueshme ose të papritura. Siç dihet, ka vetëm një gjuhë, e cila nuk ndryshon kurrë dhe kjo është gjuha e ashtuquajtur e vdekur, siç janë p.sh. latinishtja ose greqishtja klasike* (Belluscio 2016:404).

Pra, duke mos qenë e mundur, që gjuha të evoluojë e kushtëzuar brenda një shtegu të caktuar, mund të priten ndërhyrje rrethanash me prejardhje jashtë sistemit të vet gjuhës, të cilat mund të çojnë në shmangje të papritura dhe në ndryshime të tjera, në rrugën e evolucionit, në të cilën gjuha jeton (Belluscio 2016:405).

Duke pasur parasysh një gjë të tillë, edhe ky Kongres e la të hapur mundësinë e rishikimit të përfundimeve të dala prej tij, por edhe sot e kësaj dite ne nuk kemi gjetur një çast të përshtatshëm për t'u marrë me rishikimet e vendimeve të këtij Kongresi.

Në këtë kontekst, Mark Krasniqi rregullat e drejtshkrimit i quajti *Kanuni i gjuhës shqipe, kohëzgjatja e të cilit nuk mund të parashikohet*, ngase *"jeta dinamike e gjuhës imponon, kohë pas kohe, përpunimin, plotësimin dhe ndryshimin e tyre* (Cit. sipas. Vesel 2015:11).

Edhe Shaban Demiraj po këto "rregulla" i quajti *fiyt i një pune të gatë e të lëvdueshme, po me një ripunim dhe përmirësim të mëtejshëm ato do të bëhen edhe më të përshtatshme për të luajtur një rol gjithnjë e më të madh në kristalizimin e mëtejshëm të gjuhës sonë letrare kombëtare* (Vesel 2015:11).

Edhe studiuesja Shefkije Islami, e cila vazhdimisht, në veprimtarinë e saj studimore, mbron rregullat

aktuale të drejtshkrimit, në një rast shprehet: *Edhe drejtshkrimi, i cili, nga ana shkencore, nuk është më i argumentuari, është më i mirë kur respektohet, përdoret e njihet nga të gjithë, sesa ai më i arsyetuari shkencërisht, kur nuk respektohet* (Islami 38-39: 2008).

Pra, siç rezultoi, ky drejtshkrim me vendimet e veta i anashkaloi 2/3 e shqiptarëve, të cilët, në komunikimin e tyre, përdorin variantin e gegërishtes, pra mospëmbushja e nevojave të më shumë se gjysmës së folësve aktualë të shqipes ka bërë që edhe sot, mbi pesëdhjetë vjet pas Konsultës së Prishtinës dhe afër 50 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, të paraqiten probleme në pranimin e normës së folur, ky problem buron nga fakti që baza dialektore e standardit është pikërisht varieteti i jugut, i cili u zgjodh si normë për shqipen standarde. Po ashtu, një fushë tjetër, me shumë probleme për shqipen, është edhe qasja përjashtuese ndaj gegërishtes në leksik, për ç'gjë ka ndihmuar, së tepërmi, mungesa e komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet folësve të shqipes.

Pra, ky drejtshkrim, që anashkaloi një pjesë të shqiptarëve me vendimet e tij, edhe sot, afër 50 vjet pas miratimit, nuk arrin t'i përmbushë kërkesat e shumicës së folësve shqiptarë.

Natyrisht, rishikimi i këtyre rregullave duhet të nisët nga të dhënat empirike dhe ky rishikim duhet të bëhet nga ana e njohësve të rregullave të gjuhës.

Duke u nisur nga të dhënat e mësipërme, mendojmë se rishikimi i standardit duhet të ndodhë dhe jo e kundërta, që të ndodhë mbrojtja e këtij standardi.

Ekziston një bindje, se sa më e madhe do të jetë përpjekja për mbrojtjen e këtij standardi, aq më shumë mund të thellohet ndarja ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Prandaj, në këtë kontekst, vlerësohet se vetëm përfillja e të drejtës që, *me të folmen tënde, të jesh pjesë e natyrshme dhe normale e gjuhës standarde, krijon hapësirë për afirmim, sepse, në të kundërtën, shpërfillja e kësaj të drejte i bënë folësit naivë të gegërishtes, të ndihen inferiorë në raport me ata të shqipes standarde. Pra, në vazhden e këtyre vlerësimeve dhe konstatimeve, për bindjen tonë, sa më e madhe të jetë përpjekja për konservim të këtij standardi, aq më i madh do të jetë kundërshtimi ndaj tij. Prandaj, kërkesa për rishikimin e standardit, mendojmë, se, siç edhe është thënë, i forcon lidhjet e lëkundura të komunikimit gjuhësor, ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës.*

Në këtë rishikim nuk mendojmë se duhet të përmbysët ky standard aktual, pasi që ky standard, tashmë, është gjuhë e rreth 6-7 milionë shqiptarëve, e as që duhet të kthehem në vitin 1916, kur asokohe e kishim për varietet të folmen e Elbasanit, por që të dy dialektet duhet t'i shohim dhe pranojmë si vlerë në vete, pra si pasuri kulturore e gjuhësore e të gjithë shqiptarëve, pa dallim.

Në këtë kontekst, pajtohem me

mendimin e Mehmet Elezit, kur thotë: *Besoj kaq mjafton për me e kuptue se nuk i mbështes kirurgjitë e ashpra në gjuhë, nuk i mbështes përmbysjet. Nuk mendojse duhet të bëjmë atë që bëri diktatura me Komisinë Letrare të Shkodrës; boll mo, ndërto e rëno, si në legendën e Rozafës. Kemi të tjera mënyra të dobishme, ku duhet t'i shpenzojmë energjitë, aq të nevojshme në këtë kapërcyell historik* (Elezi 2010:86).

Pra, siç na e argumenton zhvillimi historik, shqipja as nuk fillon e as nuk mbaron vetëm me këtë, apo atë dialekt. Ajo është e bukur në tërësinë e saj.

Literatura

Bartsch, Renate (1987). *Norms of Language. Theoretical and Practical Aspects*. London/New York, Longman.

Beqiri, Xhavit (2006). *Gjuha standarde dhe dialektet*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 35/1.

Belluscio, Giovanni (2016). *Varietete/variante fonetike 'tendenciale' në përdorimin e kontrolluar të shqipes standarde në një emision televiziv të sotëm*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 35/1.

Byron, Janet (2002). *Përzgjedhja midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*. Dituria, Tiranë.

Çeliku, Mehmet (2001). *Çështje të shqipes standarde*. Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë.

Elezi, Mehmet (2010). *Gjuha standarde ose shqipja e qethur si ushtar. Gjuha e këputur e shqipes*, Prishtinë.

Fernández-Ordóñez, Inés (2005). *Alfonso X el Sabio en la historia del español. In Historia de La Lengua Española*, Cano, Rafael (coord.), 2d ed.

Islami, Shefkije (2008). *Konsulta gjuhësore 1986, marrëveshjet për njësimin gjuhësor*. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, Prishtinë.

Jubani-Bengu, Aljula (2008). *Shqipja letrare drejt standardizimit*, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës. Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Kler, Kramshi (2008). *Gjuha dhe identiteti kulturor. Teori dhe kritikë moderne, Rozafa*, Prishtinë.

("Lajmet e Komisionit Letrare Shqipe":1981:11).

Munishi, Shkumbin (2016). *Dialektizmi dhe variantizmi potencial i gjuhës standarde shqipe në raport me vernakularin urban*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë.

Mansaku, Seit (2003). *Zhvillime të strukturës sintaksore të shqipes dhe norma. Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Memushaj, Rahmi (2008). <http://www.gazetadita.al/komi-sia-letrare-e-shkodres-100-vjet-me-pas/>


Nuhui, Vesel (2015). *Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit*. Prishtinë.

Paçarizi, Rrahman (2010). *Jo folësit në shërbim të gjuhës, por gjuha në shërbim të folësve. Gjuha e këputur e shqipes*, Prishtinë.

Qosja, Rexhep (2008). *Konsulta gjuhësore e Prishtinës dhe vetëdija kombëtare*. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës. Instituti Albanologjik, Prishtinë.

Vehbiu, Arian (2015). <http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2015/08/27/zerat-per-ndryshim-te-standardit-politike/>

Vehbiu, Arian (2007). *Fraktalet e shqipes - rrëgjimi i gjeometrive të standardit*. Botimet Çabej.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ramadani: Edicioni i suksesshëm për Llapin, kërkohet suksese të reja

Futbollisti Arbnor Ramadani e ka vlerësuar edicionin 2020/21 të suksesshëm për skuadrën e Llapit dhe është optimist se kjo skuadër edhe në edicionin e ri do të rrëmbejë trofe. “Kemi arritur objektivat e klubit që i kishim vendosur në fillim të edicionit. Është një ndjenje jashtëzakonisht e mirë dhe shpresojmë që të vazhdojmë me suksese të tilla edhe në të ardhmen. Kemi skuadër cilësore dhe mund të luftojmë për trofe”, ka thënë Ramadani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 GUSHT - Edicioni 2020/21 për skuadrën e Llapit ishte i jashtëzakonshëm, pasi arriti ta fitojë Kupën e Kosovës dhe siguroi daljen në garat evropiane. Ani pse në Evropë nuk la gjurmë, skuadra e Tahir Batatinës e regjistroi edhe një sukses tjetër në rrafshin vendor ku në finale të Superkupës e mposhti kampionen në fuqi, Prishtinën, me rezultat 1-3. Dy gola për llapjanët i shënoi Festim Alidema dhe një tjetër e

shtoi Valmir Veliu, për Prishtinën shënues ishte Otto John. Një ditë pas këtij triumfi për “Epokën e re” ka folur Arbnor Ramadani, i cili është shprehur shumë i lumtur me suksesin e arritur nga Llapi. “Kemi arritur objektivat e klubit që i kishim vendosur në fillim të edicionit. Është një ndjenje jashtëzakonisht e mirë dhe shpresojmë që të vazhdojmë me suksese të tilla edhe në të ardhmen. Kemi skuadër cilësore dhe mund të luftojmë për trofe”, ka thënë Ramadani. Skuadra e Llapit në edicionin e ri

do të luftojë sërish për trofe, pse jo të rrëmbejë Kupën për të dytën herë radhazi. “Sa i përket mbrojtjes së titullit të Kupës nuk kemi ndonjë presion, por do ta shohim ecurinë e ndeshjeve dhe nëse na jepet mundësia, pse jo. Po ashtu, do të kërkohet edhe titullin e kampionit dhe dalja në garat evropiane sërish është synimi ynë”, ka shtuar ai. Futbollisti Arbnor Ramadani nuk ka dashur të flasë rreth skuadrave të tjera që Llapi do t'i ketë konkurrenca në garën për titull dhe Kupë, pasi një gjë të tillë preferon ta



bëjë pas fillimit të edicionit të ri. Skuadra e Llapit në afatin kalimtar të verës është përforcuar me këta futbollistë: Ilir Avdyli, Bianor Neto,

Dardan Jashari, Francisco Rivera, Festim Alidema, Adem Maliqi, Dren Ahmeti, Alban Shillova, Alef Firmino dhe Drilon Fazliu.

MKRS-ja për herë të parë do të hapë thirrje publike për subvencionimin e sportit

PRISHTINË, 18 GUSHT - Me Pakon e Ringjalljes Ekonomike planifikohet të ndahen 5 milionë euro për fushat e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit. Zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, në një konferencë për media tha se përmasat e kësaj mbështetje shtesë synojnë fuqizimin e këtyre fushave pas vështirësive që shkaktoi pandemia. Osmani ka thënë se 2.5 milionë euro do të ndahen për kulturë dhe trashëgimi kulturore. Përmes thirrjes publike do të përkrahën projekte artistike të organizatave dhe individëve (artistëve), ndërsa pjesë e skemës së mbështetjes do të jenë edhe teatrot e qyteteve, muzetë e bibliotekat komunale. Ndërsa për mbështetjen e organizatave që janë aktive në sektorin e rinisë do të ndahen 500



mijë euro. Përmes thirrjes publike do të përkrahën projekte që promovojnë fuqizimin ekonomik të të rinjve, përfshirjen në tregun e punës, ndërmarrësinë, rrjetëzimin dhe pjesëmarrjen aktive. “Dy milionë euro nga kjo masë e mbështetjes do të ndahen për zhvillimin e sportit. Kjo do të jetë hera e parë që MKRS do të hapë thirrje publike për

subvencionimin e aktiviteteve në fushën e sportit. Thirrjet publike do të hapen së shpejti, ndërsa ne do t'ju mbajmë rregullisht të informuar për të gjitha detajet për të përfutur nga kjo skemë e mbështetjes”, ka thënë Osmani. Ajo i ka ftuar të gjithë individët dhe organizatat që të aplikojnë për të përfutur nga kjo skemë e mbështetjes.

Drita ndan rrugët me Rexhën

GJILAN, 18 GUSHT - Nënkampionia e Kosovës në futboll, FC Drita, ka ndarë rrugët me sulmuesin Kastriot Rexha. Klubi gjilanas ka njoftuar se i ka ofruar Rexhës kontratë të re, por sulmuesi ka vendosur ta refuzojë. “FC Drita njofton që ka ndarë rrugët me sulmuesin Kastriot Rexha. Rexha ishte ribashkuar me klubin në janar të vitit të kaluar dhe kishte kontratë deri më 30 qershor 2021. Rexha, pas problemeve të vazhdueshme nga lëndimi në gju, nuk arriti të na ndihmojë deri në fund të kampionatit. Për pasojë, pas ndeshjes së xhiros së 28 iu desh t'i nënshtrohej operimit në gju, për ta përfunduar para kohe kampionatin. Edhe pse lëndimi do ta mbajë Rexhën jashtë fushave për një kohë, ne si klub prapë i ofruam kontratë të re për ta vazhduar bashkëpunimin me të, por që lojtari nuk e pranoi ofertën e dhënë nga klubi. Klubi ynë e falënderon Kastron për




kontributin e dhënë, duke i dëshiruar rikthim sa më të shpejtë në fushën e blertë dhe suksese kudo që do ta vazhdojë karrierën”, thuhet në njoftimin e Dritës.

Ademi: VAR-i, projekti më i madh i FFK-së

PRISHTINË, 18 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës ka bërë një tjetër hap të madh përpara, pasi të martën e ka bërë inaugurimin e sistemit të avancuar teknologjik VAR në futbollin e Kosovës. Ceremonia e inaugurimit të këtij sistemi është bërë në prag të ndeshjes së Superkupës ndërmjet Prishtinës dhe Llapit në stadiumin “Fadil Vokrri”. Presidenti Agim Ademi e ka vlerësuar këtë ditë si tejet të rëndësishme për futbollin

tonë dhe finalizimin e projektit VAR si një të arritur të madhe të FFK-së. Ai ka thënë se implementimi i këtij projekti është bërë në kohë rekorde, për çka i ka falënderuar të gjithë të përfshirët në këtë projekt gjigant. “E kemi marrë licencën nga FIFA për përdorimin e VAR-it. Nëntë operatorë dhe 53 gjyqtarë janë licencuar. Deri më tani janë organizuar 53 ndeshje, ku është testuar ky sistem. Jemi Federata që e kemi marrë licencën e VAR-it në afatin më të

shkurtër. Janë gjashtë muaj që kemi punuar intensivisht në këtë projekt, që është më i madhi ndonjëherë nga FFK. E kemi fituar një ekip profesional që do të jetë edhe në ndeshjet ndërkombëtare. VAR-i do të jetë në ndeshjet e Superligës. Në tetë stadiume është intervenuar në mënyrë që VAR-i të jetë i zbatueshëm. Ky projekt ka qenë ide e imja dhe jam i lumtur që tani po finalizohet”, ka thënë presidenti Ademi.



Atleti Muhamet Ramadani në finale të Botërorit U-20

PRISHTINË, 18 GUSHT - Garuesi Muhamet Ramadani ishte i suksesshëm në kualifikimet e hedhjes së gjyles në Botërorin e Nairobit. Sot (e enjte) do të mundohet të jetë i suksesshëm

edhe në finale. Ramadani vazhdoi me formën e tij solide edhe në Kampionatin Botëror U-20. Ramadani ishte i suksesshëm në hedhjen e gjyles, në kualifikimet e botërorit për të rinj, të cilat u

mbajtën të mërkurën. Ai e hodhi gjylen 18.89 metra, të mjaftueshme për ta rezervuar një biletë për në finalen e Nairobit. Ramadani do ta kërkojë medaljen e artë në finale, e cila do të

mbahet prej orës 14:20 me kohën tonë lokale. Ramadani po tregohet mjaft i suksesshëm në grupmoshat e reja, ndërsa shumë shpejt priten rezultate kulminante nga ai edhe te seniorët.



Ronaldo: Historia ime me Real Madridin është në muze

TORINO, 18 GUSHT - Prej muajsh e ardhmja e Ronaldos te Juventus ka qenë në dyshim, por në ditët e fundit është folur aq shumë për të ardhmen e tij dhe rikthimin e mundshëm në Madrid si dëshirë e trajnerit Carlo Ancelotti, sa duket se e ka acaruar mjaft Ronaldon. Aq shumë sa ai e ka parë të arsyeshme të dalë me një deklaratë zyrtare, për t'i përgënjeshtruar lajmet, konfirmuar qëndrimin te Juventus edhe në sezonin e ardhshëm dhe treguar qartë se sjellja e mediave ndaj tij e ka ofenduar. "Kushdo që më njeh është i vetëdijshëm se sa i fokusuar jam në punën time. Më pak fjalë dhe më shumë vepra, kjo ka qenë motoja ime që nga fillimi i karrierës. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjithçka që është thënë dhe shkruar kohët e fundit, më duhet ta përcaktoj pozicionin tim. Më shumë sesa mosrespekti për mua si njeri dhe si lojtar, mënyra joserioze e mbulimit të së ardhmes sime në media është mosrespektuese ndaj të gjitha klubeve të përfshira në këto thashetheme, si dhe ndaj lojtarëve dhe stafit të tyre. Historia ime në Real Madrid është shkruar. Është regjistruar. Në fjalë dhe numra, në trofe dhe tituj, në rekorde dhe tituj individualë. Është në muzeun e



stadiumit Bernabeu dhe është gjithashtu në mendjen e çdo tifozit të klubit. Dhe përtej asaj që kam arritur, mbaj mend se në ato nëntë vjet kisha një marrëdhënie me dashuri dhe respekt të thellë për "dashmirësinë merengue", një dashuri dhe respekt, që e ruaj deri më sot dhe që do ta çmoj gjithmonë", ka thënë Ronaldo. "Unë e di se tifozët e vërtetë të Real Madridit do të vazhdojnë të më kenë në zemrat e tyre dhe unë do t'i kem ata në timen. Përveç episodit më të fundit në Spanjë, ka pasur

lajme dhe histori të shpeshta që më shoqërojnë me një numër të klubeve në liga të ndryshme, ku askush nuk është shqetësuar për përpjekjen për të gjetur të vërtetën aktuale. Unë po thyej heshtjen tani për të thënë se nuk mund t'i lejoj njerëzit të vazhdojnë të luajnë me emrin tim. Qëndroj i fokusuar në karrierën time dhe në punën time, i përkushtuar dhe i përgatitur për të gjitha sfidat me të cilat duhet të përballim. Çdo gjë tjetër? Çdo gjë tjetër janë vetëm fjalë", ka shtuar Ronaldo.

Westbrooku shpjegon arsyen pse firmosi vetëm për një sezon me Lakersat

LOS ANXHELOS, 18 GUSHT - Askush nuk dyshon se transferimi i Russell Westbrookit në radhët e Los Angeles Lakersit ka qenë "bomba" e tregut veror në NBA. Pasi ndryshoi skuadrën tri herë në tri sezonet e fundit, nga Rockets te Wizards, mendimi i tij duket se ka ndryshuar. MVP i vitit 2017 ka ndryshuar perspektivën e tij dhe nuk mendon më në planin afatmesëm. Ai është i fokusuar vetëm për të ardhmen e afërt dhe kjo ndodh për të fituar unazën, diçka që ai nuk e arriti as në Oklahoma, as në Houston, as në Uashington. Kjo është arsyeja pse "ylli" i NBA-së nuk donte të



angazhohej me Lakersin për shumë sezone. Në parim ai do të ketë një marrëdhënie kontraktuale vetëm për një

sezon, me pagë 47 milionë dollarë. Por ju nuk doni angazhime afatgjata për atë që mund të ndodhë. Ai e di më mirë se kushdo se sa i ndryshueshëm është ky biznes në NBA. "Vizioni im për këtë Ligë është biznes. Thjesht bëj punën time dhe këtë do të vazhdoj të bëj. Nuk mund ta imagjinoj ku do të jem pas tre apo katër vjetësh. Është diçka që nuk mund ta kuptoj", ka thënë Westbrook. Megjithatë, ai e bëri të qartë se ai është gati t'i ndihmojë Lakersat ta pushtojnë unazën: "Për sa kohë që jam këtu, do të luftoj në mënyrën më të mirë që di, si do të jap gjithçka që kam".

SHKURT

Muriqi: Kam vetëbesim, jam përshtatur tek Adana

Portieri Arijanet Muriqi ka debutuar në Ligën e Turqisë me Adana Demirsportin ndaj ekipit të madh, Feberbahçes, këtë të diel. Reprerentuesi i Kosovës është transferuar në Turqi në formë huazimi, ku edhe humbi ndeshjen e parë debutuese. Në një prononcim për mediat turke, Muriqi ka thënë se ka shumë vetëbesim. "Kam shumë vetëbesim. Jemi përshtatur shpejt me njëri-tjetrin. Ambienti është shumë i mirë. Jam duke ushtruar që dy javë dhe po jap më të mirën nga vetja. Do të përmirësohem me kalimin e kohës", ka deklaruar Muriqi. Kayserspori do të jetë kundërshtari i radhës për Adana Demirsport, takim i cili zhvillohet ditën e premtë.

Batshuayi huazohet te Beshiktashi

Beshiktashi ka konfirmuar huazimin e sulmuesit Michy Batshuayi nga Chelsea. Sulmuesi belg nuk ka pasur vend në formacionin e Chelseat, andaj edhe ka kaluar te klubi turk, ku është huazuar me opsion blerje. Dy klubet janë pajtuar nga ana financiare, derisa Batshuayi do ta mbajë numrin 9 në fanellë. Përmes një postimi në rrjetin social, Beshiktash publikoi një video të 'Batman', që është simbol që shpesh e përdor lojtari.

Kroosi, pas transferimit të Messit në Francë: Ndoshta një lojtar nga PSG-ja vjen në Real

Mesfushori i Real Madridit, Toni Kroos, ka folur së fundmi për transferimin e Leo Messit te PSG dhe gjermani thekson se për skuadrën e tij nuk ka një disavantazh nga kjo. Madje ai shpreson që Mbappe të kalojë te Real Madridi prej transferimit të Messit në Francë, edhe pse nuk përmend emra. "Do të shohim se si do të funksionojë gjithçka për Messin te PSG. Ndoshta lëvizja është e mirë për ne, sepse konkurenti ynë më i madh ka humbur lojtarin më të mirë. Dhe ndoshta edhe më shumë gjëra të mirë do të dalin prej kësaj. Ndoshta një lojtar nga PSG do të bashkohet me ne... Nëse kjo do të ndodhë, nuk e di. E gjithë kjo lëvizje e Messit, sigurisht që nuk do të jetë një disavantazh për ne", ka thënë ai.

Rosberg: Ja çfarë duhet të bëjë Verstappen për ta mundur Hamiltonin

Piloti gjerman Nico Rosberg është i vetmi që ka mposhtur britanikun Lewis Hamilton dhe është shpallur kampion bote në Formula 1 (sezoni 2016) gjatë viteve të dominimit të Mercedesit. Ata kanë qenë shokë skuadre te makina gjermane, por mes tyre dualizmi dhe rivaliteti në pistë ka qenë shumë i madh. Sipas Rosberg, piloti i Red Bull, Max Verstappen, që këtë vit po duelon me Hamiltonin për titullin, duhet të ndryshojë mentalitetin në mënyrë që t'ia dalë mbanë. "Është e nevojshme që Verstappen të ndryshojë mentalitetin në duelin ndaj Hamiltonit. Kjo ishte ajo që bëra unë pas disa dështimeve që pata ndaj Lewisit", ka thënë Rosberg. Ai kujton momentin që bëri ndryshimin e madh: "Kisha humbur 3 sezone radhazi duelin me Lewisin dhe në sezonin e fundit kisha vuajtur shumë. U mbylla me çelës në dhomën time të hotelit dhe i vura detyrë vetes të shtyhesha përtej limiteve, pa pushim. Kjo më ndihmoi ta përmirësoj motivimin tim dhe natyrisht objektivin".

Rose: Haalandi mund të qëndrojë gjatë në Dortmund

Trajneri i Borussia Dortmundit, Marco Rose, ka thënë se sulmuesi Erling Haaland mund të qëndrojë edhe pas sezonit 2021/2022 në Borussia

Dortmund. "Ai ka ende kontratë afatgjatë me ne. Vetëm sepse flitet se ai mund të largohet vitin e ardhshëm nga Dortmund, nuk do të thotë se do të

ndodhë. Në fund, Erling është ai që vendos për të ardhmen e tij. Sido që të jetë, ne jemi të lumtur që ai aktualisht luan për ne dhe kush e di, ndoshta do

të jetë më shumë se vetëm edhe një sezon për të shkruar histori të jashtëzakonshme këtu", ka thënë Rose për "Sport Bild".



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

